




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor


**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 18.05.2026 DERI MË 22.05.2026

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-7372-2026
2.	Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës të Avokatit Komunal.	NRP-02-7374-2026
3.	Vendim për pezullimin e përkohshëm të marrdhënies së punës.	NRP-02-7376-2026
4.	Vendim për pezullimin e përkohshëm të marrdhënies së punës.	NRP-02-7377-2026
5.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të mjekim dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.	NRP-02-7378-2026
6.	Vendim për miratimin e kërkesës për ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve të vazhdimit të studimeve.	NRP-02-7382-2026
7.	Vendim për Mbulimin e shpenzimeve financiare për botimin e librit me titull: "Mbretëria e bashkuar dhe lufta e Kosovës 1998 – 1999".	NRP-02-7383-2026



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0016124/26 dt. 15.05.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj [redacted] nga Rahoveci me datë 15.05.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 07.05.2026 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj [redacted] dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023”), lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025”), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e ushtruesit të detyrës të Avokatit Komunal

1. Fiknete Kasapi - Iska, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtare Ligjore në Sektorin Ligjor, në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës, **CAKTOHET** ushtruese detyre e Avokatit Komunal, nga data 1.6.2026 deri më 31.5.2027.
2. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Komunës janë të përcaktuara me Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017 dhe me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit, me nr. prot. 01 Nr. 102/26, të datës 25.2.2026.
3. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi do t’i takojë kompensimi i pagës sipas koeficientit të Avokatit të Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi më 1.6.2026.

Arsyetim

Duke marrë parasysh se pozita e Avokatit të Komunës është e lirë (vakante), si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe të detyrave të cilat dalin nga ky vend i punës, është i domosdoshme caktimi i ushtruesit të detyrës së Avokatit të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Fiknete Kasapi - Iska, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtare Ligjore në Sektorin Ligjor, në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës, caktohet ushtruese detyre e Avokatit të Komunës, nga data 1.6.2026 deri më 31.5.2027.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të vendimit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me vendim të njoftohen:

- Fiknete Kasapi-Iska,
- Udhëheqësi i Sektorit Ligjor,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa,
- Njësia e Personelit, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAÇ/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7376 Nr. i faq./Br.str./No.pg 40
Data/Datum/Date 20 / 05 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 25, nenit 68 paragrafi 1, nenit 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 13 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës

1. **Znj. Tringa Morina**, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në Çerdhen e Fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec - paralelja e ndarë në Krushë e Madhe, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026.
2. Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës sipas pikës 1 të këtij vendimi, fillon 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës, konkretisht nga data 21 maj 2026 deri më datë 12 qershor 2026.
3. E lartpërmendura e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të pezullimit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim, Çerdhja e Fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Znj. Tringa Morina, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në Çerdhen e Fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec - paralelja e ndarë në Krushë e Madhe, është kandidatë për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026.

Në nenin 25, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është e përcaktuar që zyrtarët publikë të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 25, nenin 68 paragrafi 1, nenin 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 13, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, znj. Tringa Morina, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026, respektivisht nga data 21 maj 2026 deri më datë 12 qershor 2026, me të drejtën e kthimit në vendin e punës pas përfundimit të këtij pezullimi.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Znj. Tringa Morina,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivit.*

Smajl Latifi



Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
<small>KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET</small>		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>7377</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>40</u>		
Data/Datum/Date <u>20/05/26</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 25, nenit 68 paragrafi 1, nenit 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 13 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës

- Znj. Shqipe Zenunaj**, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në ShFMU “Rudolf Walther” në Dejnë - paralelja e ndarë në Dobidol, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026.
- Pezullimi i përkohshëm i marrëdhënies së punës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, fillon 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës, konkretisht nga data 21 maj 2026 deri më 12 qershor 2026.
- E lartpërmendura e ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme pas përfundimit të pezullimit të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. Shqipe Zenunaj, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Edukatore në ShFMU “Rudolf Walther” në Dejnë - paralelja e ndarë në Dobidol, është kandidatë për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026.

Në nenin 25, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është e përcaktuar që zyrtarët publikë të cilët kandidojnë për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojnë vendin e punës 7 (shtatë) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të fushatës dhe përfundon 5 (pesë) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 25, nenin 68, paragrafi 1, nenin 69, paragrafi 1 nënparagrafi 1.8, lidhur me nenin 86 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe nenin 13, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, znj. Shqipe Zenunaj, i pezullohet përkohësisht marrëdhënia e punës, pa pagesë, për shkak të kandidimit për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme, të cilat do të mbahen më 7 qershor 2026, respektivisht nga data 21 maj 2026 deri më 12 qershor 2026, me të drejtën e kthimit në vendin e punës pas përfundimit të këtij pezullimi.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Znj. Shqipe Zenunaj,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivit.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Prot. 1662 e datës 27.4.2026 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Dretorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe do të derdhen në xhirrollogarinë Nr. [redacted] bank, në emër të [redacted].
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted] nga Rahoveci, vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për intervendim përmes operacionit si dhe për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj.

Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërbalueshme për të dhe familjen e tij.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAÇ / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7382 Nr. i faq./Br.str./No.pg 41
Data/Datum/Date 21 / 05 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAÇ

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 14 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.04.2017 dhe kërkesës së Lavdije Ramadanit nga fshati Krushë e Madhe, me nr. prot. 1877, të datës 18.5.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, me nr. prot. 1877, e datës 18.5.2026, për ndihmë financiare (bursë e studimeve) prej 450.00€ (katërqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të vazhdimit të studimeve.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted] është studente e vitit II të nivelit baçelor, në drejtimin Infermieri, në Kolegjin “Universum” në Gjakovë dhe ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 1877, të datës 18.5.2026, me të cilën ka kërkuar bursë studentore, si ndihmë financiare për vazhdimin e studimeve.

Duke marrë parasysh se e lartpërmendura është duke udhëtuar me transport publik për të vazhduar studimet dhe për këtë ka kosto financiare, e cila është e papërbalueshme për të, është e domosdoshme dhënia e bursës dhe ndihma për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [redacted] nga fshati Krushë e Madhe,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Drejtoria për Arsim, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7383 Nr. i faq./Br.str./No.pg 41
Data/Datum/Date 21/05/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 22 paragrafi 1 pika 1.7 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] me nr. protokolli 1907, e datës 21.5.2026, për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro), për mbulimin e shpenzimeve të botimit të librit me titull “Mbretëria e bashkuar dhe lufta e Kosovës 1998-1999, debatet parlamentare”.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[REDAKTUAR] si njëri nga shumë shkrimtarët dhe publicistët, ka marrë iniciativë për botimin e librit me titull “Mbretëria e bashkuar dhe lufta e Kosovës 1998-1999, debatet parlamentare”, i cili përshkruan luftën e fundit në Kosovë, respektivisht rolin e kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar, Toni Blair, Robin Cook dhe Lord Robertson në përpjekjet e Kosovës për pavarësi, si dhe në përpjekjet e mëvonshme për ndërtimin e paqes.

Andaj, duke marrë parasysh se i lartpërmenduri e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve në lidhje me botimin e këtij libri, është e domosdoshme ndihma financiare dhe përkrahja institucionale për mbulimin e shpenzimeve për botimin e këtij vëllimi me rëndësi për lexuesit.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.

